

VENDIM
Nr. 610, datë 27.10.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 7, DATË 11.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2017 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 7, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1 të vendimit, numri i punonjësve dhe i praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “...2 401 punonjës.”.

2. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 1 të vendimit, bëhen këto shtesa:

Në ndarjet “Gr. 29 Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”, “Gr. 73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, “Gr. 87 Institucione të tjera qeveritare”, shtohen nëndarjet përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në pikën 2 të vendimit, pas fjalëve “... Drejtorisë së Dëmshpërblimit të ish-të Përndjekurve Politikë ...” shtohen “... dhe tre punonjësit e kontraktuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
29	Zyra Administrimit të Buxhetit Gjqësor	3			
	Gjykatat e Apelit Tiranë	1	Sanitar	8 orë / ditë	3- muaj
	Gjykata Administrative e Rrethit Vlorë	1	Sekretare Gjyqësore	8 orë / ditë	3- muaj
	Gjykatat e Rretheve Dibër	1	Punonjës sigurie	8 orë / ditë	3- muaj
73	Komisioni Qendro i Zgjedhjeve	7			
	Aparati i KQZ	7	operator/arkivist	8 orë / ditë	3- muaj
87	Institucione te tjera qeveritare	2			
	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale	1	Sanitar	8 orë /ditë	3- muaj
	Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale	1	Puntor mirmbajtjeje	8 orë /ditë	3- muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	12			